

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush fshihet pas kokainës në Durrës? Dyshime se u trafikua nga grupi i Gerd Gjinararit në Belgjikë - Info rmohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/kush-fshihet-pas-kokaines-ne-durres-dyshime-se-u-trafikua-nga-grupi-i-gerd-gjinararit-ne-belgjike/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:36:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:25:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	11bb56c21ea524960822b4d83930ca5cc65055e9052307886d837f564a73d031
TEKSTI	df9f362b4520df78df9774329c3771f2deccdc811b0dae90e3f49c698c032bc6
PAMJA	e6132a0cb85d82c43d90699f399efd406a6aafb5aac7a51dcc3f14bdae7a491d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5f4b32a8e0dc45b50e7432252c1364ddce5a32e568e200b3cf4e123aa5d751cf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5f4b32a8e0dc45b50e7432252c1364ddce5a32e568e200b3cf4e123aa5d751cf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Kush fshihet pas kokainës në Durrës? Dyshime se u trafikua nga grupi i Gerd Gjinararit në Belgjikë

AKTUALITET

Demo

Kush fshihet pas kokainës në Durrës? Dyshime se u trafikua nga grupi i Gerd Gjinararit në Belgjikë

SEPTEMBER 15, 2026



37 pakot me kokainë të kapura në Portin e Durrësit një ditë më parë (më 14 shtator) në hapësirat e jashtme të një kontejneri frigoriferik me mish pule, dyshohet se janë të lidhura me grupin e Gerd Gjinararit, i njohur si "Gjenerali", i arrestuar pak muaj më parë në Belgjikë. Njoftimi u bë nga autoritetet belge të cilat goditën po dje grupin e shqiptarëve të përfshirë në trafikun e kokainës.

Në Shqipëri, 37 pakot e kokainës së gjetura të hënën, në kontejnerin që transportonte mish pule nga Brazili, kanë mbetur jetime, pa asnjë të dhënë mbi destinacionin apo personat që fshihen pas ngarkesës.

Por në të njëjtën ditë që ajo u zbulua në portin e Durrësit, në Belgjikë autoritet e atjeshme njoftonin për goditjen e një grupi shqiptar të trafikut të kokainës, në Antwerp, falë një hetimi në bashkëpunim me disa vende, që kishte çuar dhe në kapjen e drogës në Shqipëri.

Lidhjen mes dy ngjarjeve e bën vetë zëdhënësi i Prokurorisë së Antwerpit, Kristof Aerts.

"Si pjesë e hetimit, u zhvillua një bashkëpunim i ngushtë me vendet e tjera dhe me Europolin. Kjo mund të rezultojë në arrestime jashtë vendit. Pas ndërhyrjes, një ngarkesë prej 37 kilogramesh kokainë u sekuestrua në Shqipëri, në një kontejner frigoriferik", tha Kristof Aerts, zëdhënësi i Prokurorisë së Antwerp-it.

Burime për Report Tv bëjnë me dije se çështja është referuar në SPAK, i cili pritet të marrë në vijim hetimin e plotë. Kokaina e nisur nga Brazili, kishte kaluar më parë tranzit përmes Greqisë.

Në Antwerp, grupi i narkotrafikantëve të goditur, rezultojnë të jetë i lidhur me një personazh të njohur të botës së krimit në Shqipëri, Gerd Gjinarari, i arrestuar po në Belgjikë në muajin qershor. Tetë pjesëtare të grupit përfunduan në pranga, mes tyre një 48-vjeçar shqiptar, i dyshuar si ndërmjetës mes grupeve kriminale në Shqipëri dhe Amerikës Latine. Sipas hetuesve belge, ai siguronte lidhjet për importimin e sasive të mëdha të kokainës, përmes portit të Antwerp-it, dhe kishte komunikime edhe me grupe të trafikut të drogës në Evropë e deri në Australi.

Emri i tij mbetet akoma mister, por ai rezultojnë të ketë qenë në kontakt pikërisht me Gerd Gjinararin, një personazh me një të kaluar të hershme kriminale. Ai ishte 23 vjeç kur në vitin 1997 vrau Naim Zyberin në një spital në Milano, dhe bashkë me disa vepra penale u dënua me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Krimeve të Rënda e Milanos, vendim i formës së prerë që prej vitit 2001. Në 2014-ën u soll në Shqipëri për vijimin e dënimit, dhe në shkurt 2019 u lirua me kusht nga gjyqtari Markelian Kuqo në Korçë, vetëm pak kohë pasi u transferua në burgun e Drenovës. Kur Apeli pak javë më vonë vendosi rikthimin e tij qeli, ishte arratisur.

Postimet e reja

Kush fshihet pas kokainës në Durrës? Dyshime se u...

SEPTEMBER 15, 2026

Rifillimi i shkollës, Policia e Fierit kontrollon ndaj...

SEPTEMBER 15, 2026

Shtohen rastet me kancer të gjakut, hematologu...

SEPTEMBER 15, 2026

Stadiumet e finaleve të Champions-it/ "Allianz..."

SEPTEMBER 15, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfutuesit, qokat dhe "problematicët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu